

## PRIMARY SCHOOL PUPILS (DIS)INTEREST FOR THE ALBANIAN LANGUAGE

### (MOS)KUJDESI I FILLORISTËVE NDAJ GJUHËS SHQIPE

Zymbyle AMETI<sup>1</sup>

*1\* Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

*\*Corresponding author e-mail: zymbyle.ameti@unite.edu.mk*

---

#### **Abstract**

Great technological advances have brought children into the digital world, replacing with the "world" they carry in their pockets, pens, notebooks and books, but most worryingly, they have also begun to abandon their native language, embracing the foreign language more easily. The aim of this paper is to investigate how much schoolchildren care about writing their language without mistakes, which part of the Albanian language subject they prefer the most and what they want to change to make learning the Albanian language easier.

The paper presents hypotheses, arguments and conclusions based on data collected from a survey with pupils of municipal elementary schools of the city of Gostivar (two hundred four pupils). During the research, the direct survey method was used to collect concrete data from the pupils and the descriptive method was used for the theoretical explanation of the problem we are investigating.

The results of the research showed that elementary school pupils prefer literature more than language and don't care enough to write Albanian without mistakes.

**Keywords:** elementary school pupils, language avoidances, language, literature etc.

#### **Përmbledhje**

Zhvillimet e mëdha teknologjike kanë bërë që fëmijët të jenë të zhytur në botën digjitale duke i zëvendësuar lapsat, fletoret e librat me "botën" që mbajnë në xhep, por më shqetësues është fakti që kanë filluar të largohen edhe nga gjuha e tyre duke e përqafuar më lehtë gjuhën e huaj. Qëllimi i këtij punimi është të hulumtojë sa kujdesen shkollarët për shkrimin pa gabime të gjuhës së tyre, cilën pjesë të lëndës së gjuhës shqipe e parapëlqejnë dhe çfarë duan të ndryshojnë që mësimi i gjuhës shqipe të jetë më i lehtë.

Punimi i ka shtruar hipotezat, argumentet dhe përfundimet duke u bazuar në të dhënat që janë mbledhur nga anketa e realizuar me nxënësit e shkollave fillore komunale të qytetit të Gostivarit (dyqind e katër nxënës). Gjatë realizimit të hulumtimit janë përdorur metoda e anketimit të drejtpërdrejtë për të mbledhur të dhëna konkrete nga nxënësit dhe metoda përshkruese për shpjegimin teorik të problemit që hulumtohet. Rezultatet e hulumtimit treguan se filloristët e parapëlqejnë më shumë letërsinë sesa gjuhën dhe nuk kujdesen mjaftueshëm që ta shkruajnë shqipen pa gabime.

**Fjalët kyçe:** filloristët, shmangiet gjuhësore, gjuha, letërsia etj.

## Hyrje

Gjuha është thelbi i identitetit tonë kombëtar. Përtej fjalëve, ajo mbart historinë, traditën dhe vlerat tona, andaj është obligim e detyrë që ta ruajmë e kultivojmë. Por, sot përballemi me një realitet ku shumë nxënës s'kanë interesim e entuziazëm që të mësojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën shqipe. Ky fakt shqetësues nxit kërkime e studime të ndryshme që kanë për synim të kuptohen shkaqet dhe mënyrat që do të mundësojnë rritjen e interesimit të shkollarëve ndaj gjuhës së tyre.

Ne nëpërmjet këtij punimi mëtojmë të hulumtojmë cila pjesë e lëndës së gjuhës shqipe u parapëlqen nxënësve, çfarë do të donin të ndryshonin gjatë zhvillimit të orës së gjuhës shqipe, sa kujdesen ata për gjuhën e tyre, a është i madh numri i nxënësve që u vjen më lehtë të shprehin në gjuhë të huaj si dhe a hasin nxënësit gabime gjuhësore te librat shkollorë. Hipotezat që kanë nxitur këtë hulumtim janë dy:

Filloristët e pëlqejnë më shumë letërsinë sesa gjuhën.

Nxënësit hasin gabime gjuhësore në librat shkollorë.


Për të testuar hipotezat e mësipërme kemi përdorur metodën e anketimit të drejtpërdrejtë (në të cilën morën pjesë dyqind e katër filloristë) dhe metodën përshkruese, me të cilën kemi bërë një përshkrim teorik të problemit të trajtuar. Jemi të mendimit se duke i kuptuar pengesat, nevojat dhe preferencat e nxënësve, mund të ndërtojmë metoda të përshtatshme mësimore që do të bëjnë gjuhën tonë të jetë pjesë e rëndësishme e përditshmërisë së tyre.

### I. Pasqyrimi i rezultateve


Për të parë sa kujdesen nxënësit që të shkruajnë drejt e pa gabime gjuhën e tyre dhe sa janë të afërt me të kërkuam nga ta të plotësonin formularin e mëposhtëm.

	Asnjëherë	Rrallë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
Gjatë leximit të mësimeve vërej gabime gjuhësore në libër.					
Kur nuk kuptoj ndonjë fjalë ia shoh kuptimin në <i>Fjalor</i> .					
Ndonjë fjalë më vjen më lehtë ta përdor në gjuhën angleze.					


Përgjigjet e fituara për secilin pohim të parashtruar janë si më poshtë:



**Grafikoni 1:** Përgjigjet e filloristëve për pohimin I



**Grafikoni 2:** Përgjigjet e filloristëve për pohimin II



**Grafikoni 3:** Përgjigjet e filloristëve për pohimin III

Po të analizojmë përgjigjet e dhëna vërejmë se filloristët hasin gabime gjuhësore te librat, rrallë e shfletojnë *Fjalorin* dhe shpesh u kujtohen më lehtë fjalët në gjuhë të huaj. Se u vjen më lehtë të shprehen në gjuhë të huaj nuk e dëshmojnë vetëm përgjigjet për pohimin III të dhënë në formular, por edhe përdorimi i tyre gjatë dhënies së përgjigjeve për ushtrimet e parashtruara. Gjithashtu gjatë bisedimit të lirë që e realizuam vërejtëm se jo pak nxënës (sidomos të klasave të gjashta) e flisnin shqipen me theks të gjuhës angleze.

*1.1. Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj:* Puna e pastrimit të shqipes nga “mikroorganizmat e huaj” ka traditë të vjetër. Vrull më të madh pati gjatë periudhës së Rilindjes, rilindësit ndër tjera i kushtuan kujdes të veçantë edhe zëvendësimit të fjalës së huaj me fjalë që frymojnë shqip. Por, edhe përkundrajt punës së madhe që bënë ata e pasardhësit e tyre, shqipes vazhdimisht i shtohen fjalë të huaja pa pasur nevojë. Për të parë sa nxënësit janë të prirë t’u shmangen fjalëve të huaja kërkuam nga ta të zëvendësojnë fjalët: avantazh, bravo dhe fals, me fjalë shqipe. Më poshtë do t’i shqyrtojmë përgjigjet për secilën fjalë në veçanti.

Për zëvendësimin e fjalës avantazh siç shihet në tabelën e mëposhtme janë dhënë përgjigje të ndryshme. Ka edhe nga ta që kanë zëvendësuar fjalën avantazh me fjalë tjetër të huaj, siç është rasti i zëvendësimit të saj me fjalën “shansa”. Përgjigje të saktë kanë dhënë 3,9% e nxënësve duke e zëvendësuar fjalën avantazh me fjalën epërsi.

**Tabela 1:** Përgjigjet për zëvendësimin e fjalës avantazh

Përgjigje	Nr.	%
Epërsi	8	3.9
Përparsi	103	50.5
Avancim	7	3.4
Shansa	5	2.5
Vazhdim	3	1.5
Përfitim	7	3.4
pa përgjigje	40	19.6
Strategji	3	1.5
Përparësi	28	13.7
Total	204	100.0

avantazh, ~i m. Kësaj fjale i përgjigjet në kuptimin kryesor fjala shqipe epërsi: Avantazh i madh — Epërsi e madhe. Ka avantazh — Ka epërsi. Rriti avantazhin — Rriti epërsinë etj. Epërsi mund të shtihet edhe në disa thënie të terminologjisë sportive, si Kaloi në avantazh — kaloi në epërsi etj. Në një kuptim tjetër ajo zëvendësohet me fjalët përfitim, e mirë, p.sh.: Avantazh material — Përfitim material etj. Nuk sjell ndonjë nuancë kuptimore a ngjyrim emocional të veçantë që të përligjë sot përdorimin e kësaj fjale. [Kelmendi, 2000: 12]

Pasthirrma bravo ka një përdorim të gjerë nga shqipfolësit e shtresave të ndryshme. Por, edhe pse përdoret shpesh si në ligjërimin bisedor ashtu edhe në atë të shkruar, 70% e nxënësve kanë arritur të bëjnë zëvendësimin e saj me pasthirmën e shqipes të lumtë. Vlen të theksohet që përgjigjet e dhëna dëshmojnë se edhe gjatë shkrimit të kësaj pasthirme filloristët bëjnë gabime drejtshkrimore, pasi siç shihet edhe në tabelë 30% e tyre e kanë shkruar fjalën pa -ë fundore.

**Tabela 2:** Përgjigjet për zëvendësimin e fjalës bravo

Përgjigje	Nr.	%
të lumt	61	29.7
të lumtë	84	41.2
Super	27	13.2
punë e mirë	3	1.5
shumë mir	2	1.0
Apllauz	4	2.0
shum mir	3	1.5
Bukur	3	1.5
Mire	3	1.5
pa përgjigje	14	6.9
Total	204	100.0

Për zëvendësimin e fjalës fals vetëm 9,3% kanë dhënë përgjigje të saktë duke e zëvendësuar me fjalën e rremë. Duhet theksuar se përpos përqindjes së vogël për përgjigjen e saktë, rreth 30% e nxënësve janë përgjigjur duke e zëvendësuar fjalën fals me fjalë tjera të burimit të huaj si: fake, jo origjinale etj.

fals, ~e mb. Kjo fjalë me burim të huaj, që “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” e çon te fjala “i rremë”, në shumë raste mund dhe duhet të zëvendësohet me këtë fjalë shqipe të rremë. P.sh. në vend të: Monedhë false. Dëshmi false. Miqësi false. Lajm fals. Çelës fals etj., mund të thuhet: Monedhë (miqësi, dëshmi) e rreme. Lajm i rremë. Çelës i rremë etj. [Ibid.:26]

**Tabela 3:** Përgjigjet për zëvendësimin e fjalës fals

Përgjigje	Nr.	%
jo e vërtet	22	10.8
jo origjinale	11	5.4
Ren	3	1.5
Gënjeshtër	5	2.5
Imitim	4	2.0
i rremë	19	9.3
Fallc	24	11.6
jo reale	2	1.0
Gabim	32	15.7
Fake	37	18.1
Falcifiko	3	1.5
Replikë	4	2.0
e pasaktë	3	1.5
pa përgjigje	26	12.7
e pavërtetë	1	0,5
jo e vërtetë	2	1.0
i rrejshëm	6	2.9
Total	204	100.0

Mund të themi se filloristët i përdorin fjalët e huaja duke qenë të vetëdijshëm se janë të tilla (bazuar në rezultatet e fituara për fjalët e mësipërme). Këtë e dëshmon, jo vetëm përdorimi i tyre në përgjigjet e ushtrimeve tjera të parashtruara, por edhe shfrytëzimi i tyre gjatë bisedimit të lirë të realizuar me ta.


## II. Këshilla për përmirësime

Jemi të mendimit se për t’u ngjallur interesimi ndaj gjuhës duhen bërë disa ndryshime në mënyrën e mësimdhënies dhe organizimit të orës së gjuhës shqipe. Se cili është ndryshimi që duhet bërë më mirë se çdokush mund të na e tregojnë vetë nxënësit. Andaj, nga ta kërkuam të shprehin idetë e tyre se ç’duhet të ndryshojë që mësimi i gjuhës shqipe të jetë më i lehtë e tërheqës, si dhe të tregojnë cilën pjesë të lëndës e pëlqejnë më shumë. I gëzohemi faktit që nxënësit s’nguruan të shprehin idetë e tyre.

Më poshtë do të shënojmë disa nga idetë që filloristët dhanë rreth asaj që do të donin të ndryshonin që mësimi i gjuhës shqipe të ishte më i lehtë:

1. Të kemi mjete më të mira mësimore.
2. Mësimet në gramatikë të kenë më shumë sqarime.
3. Të mos marrim shumë shënime dhe shpjegimi i njësive të jetë më i qartë.
4. Të kemi më shumë aktivitete gjatë orës mësimore.
5. Të përdorim më shumë pajisje elektronike.
6. Të ketë më shumë ushtrime gramatikore.
7. Përkufizimet që na jepen të jenë më të shkurtra.
8. Të kemi njësi të barabarta si në letërsi edhe në gramatikë.
9. Të ndryshohen lektyrat.
10. Mësimi të jetë më argëtues.
11. Të kemi më pak teste gjatë vitit shkollor.
12. Të jenë më të qarta mësimet në gramatikë.
13. Të lexojmë vepra me kuptim më të mirë.
14. Gramatika të jetë më e lehtë.

Jemi të mendimit se idetë e dhëna nga filloristët përpos që janë interesante, janë edhe ide që duhet të merren për bazë nëse synojmë që interesimi dhe kujdesi ndaj gjuhës të rritet. Sa u përket rezultateve për pyetjen se cilën pjesë të lëndës së gjuhës shqipe e pëlqejnë më shumë, janë si më poshtë:



**Grafikoni 4:** Përgjigjet e të anketuarve për pjesën e preferuar të lëndës

Jo vetëm nga përzgjedhja e pjesës së preferuar, por edhe nga ajo se çfarë duan të ndryshojnë u vërtetua se nxënësit janë më të afërt me letërsinë e i qasen më lehtë asaj. Më shumë se 80% e nxënësve zgjodhën letërsinë si pjesën e pëlqyer të lëndës, ndërsa një përqindje jo e vogël u përgjigjën se do të donin gramatika dhe sqarimi i saj të ishte më i qartë që mësimi i lëndës të ishte më i lehtë.

## Përfundimi

Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se: filloristëve jo rrallë ju vjen më lehtë të shprehën në gjuhë të huaj; ndonjëherë hasin gabime gjuhësore në librat shkollorë, gjë që deri diku e vërteton hipotezën e parë të studimit; kur s’kuptojnë ndonjë fjalë rrallë e shfletojnë fjalorin; i tërheq më shumë letërsia sesa gjuha, që gjithashtu e vërteton hipotezën e dytë.

Nxitja e interesimit për gjuhën shqipe është detyrë e përbashkët. Shkolla ka ndikim parësor te nxënësit në mësimin e shqipes standarde, andaj duhen bërë disa ndryshime edhe në mënyrën e mësimdhënies për rritjen e interesimit të filloristët, si: sqarimi i lëndës në përgjithësi e i gramatikës në veçanti duhet të jetë i orientuar në përdorimet praktike, duhet të ketë më shumë aktivitete gjithëpërfshirëse për zotërimin e shqipes standarde etj. Është shumë e rëndësishme që mësuesit të jenë të hapur ndaj risive dhe të gjejnë mënyrat e duhura për ta bërë mësimin frymëzues dhe tërheqës për nxënësit.

Roli i prindërve është gjithashtu shumë i rëndësishëm. Ata duhet të përkushtohen që fëmijëve t'ua mësojnë shqipen standarde ashtu siç përkushtohen ndaj mësimin të gjuhëve të huaja. Duhet të krijohet një mjedis mësimor që frymëzon dashurinë dhe krenarinë për gjuhën tonë, duke ndihmuar kështu në formimin e një brezi që kujdeset për gjuhën e tyre.

## Referencat

- [1]. Ajdini-Murtezi, Sh., Saliu, B., Saliu, D. (2022). Gabimet gjuhësore në tekstet e përkthyer të arsimit fillor. Albanologjia. Vëllimi IX, nr. 17-18, f. 242-249. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- [2]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe I. Tiranë.
- [3]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002). Gramatika e gjuhës shqipe II. Tiranë: Maluka.
- [4]. Dibra-Zeqiri, F. (2022). Kurrikulat e gjuhës shqipe dhe të letërsisë në arsimin parauniversitar në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë e Shqipëri. Albanologjia. Tetovë: vëllimi IX, nr. 17-18, f. 90-101. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.
- [5]. Kelmendi, Sh. (2000). Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj. Mitrovicë.
- [6]. Memushaj, R. (2012). Për shqipen standarde I. Tiranë: Infbotues.
- [7]. Memushaj, R. (2005) Shqipja standarde. Tiranë: Toena.
- [8]. Ndreca, M. (2007). Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe. Tiranë: Toena.
- [9]. Sulejmani, B. (2015). Ç'përkthime lexojnë sot fëmijët tanë?! Filologjia. Vëllimi IX, nr. 15-16, f. 22-30. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës.